



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPOT VIETOR ANNUAL REPORT

2020



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT VJETOR ANNUAL REPORT

2021



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Publikimi i Raportit Vjetor është realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit me mbështetjen financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit, Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe Cordaid.

The publication of the Annual Report has been realized by the Albanian Helsinki Committee with the financial support of Swedish Helsinki Committee, Norwegian Helsinki Committee and Cordaid.

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights



Norwegian Helsinki Committee



© **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Punoi: Prof.as.dr. Vasilika Hysi
Erida Skëndaj
Redaktimi letrar: Maria Mato

© **Albanian Helsinki Committee**

Prepared by: Prof.as.dr. Vasilika Hysi
Erida Skëndaj
Editing Maria Mato

Nëse jeni të interesuar për këtë botim, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Everyone interested in obtaining this publication, might contact the Albanian Helsinki Committee in the address below:

Rr. "Gjin Bue Shpata", pall. 5/I, ap.4, Tiranë, Albania

Tel: 04 2233671

E-mail: office@ahc.org.al; web-site: www.ahc.org.al

Design & Press
Visi Design



Përmbajtja

Content

Fjala përshëndetëse

1. Veprimtaria e KSHH-së sipas fushave

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit në vitin 2007
- Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të njeriut - një domosdoshmëri për respektimin më të mirë të drejtave të njeriut
- Reforma ligjore ka rëndësi, por jo pak rëndësi ka cilësia e saj
- Përmirësimi i praktikave të zbatimit të ligjeve – nën fokusin e KSHH-së
- Bashkëpunime/Veprimtari të përbashkëta me institucione vendase, të huaja dhe OJF
- Veprimtari sensibilizuese të publikut nëpërmjet medias

2. Veprimtaria e KSHH-së sipas projekteve

- Veprimtari monitoruese e të drejtave të njeriut dhe zhvillim institucional i organizatës
- Monitorimi i progresit të respektimit të të drejtave të njeriut në kuadër të marrëdhënieve Shqipëri-BE

Introductory speech

1. Activity of AHC according the fields

- The Albanian Helsinki Committee in 2007
- Monitoring respect for human rights – indispensable for better respect for human right
- Legal reform is important, its quality not less
- Improvement of the practice of law enforcement – in AHC's focus
- Cooperation/Joint activities with local, foreign institutions, and NGOs
- Public sensitization activities through the media

2. Activity of AHC according the projects

- Activities to monitor human rights and organization's institutional development
- Monitoring progress of respect for human rights in the context of Albania-EU relations

- Për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të viktimave në Shqipëri
- Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare
- Respektimi i interesit më të lartë të fëmijëve – Detyrim për të gjithë
- Drejtimi human i burgjeve shqiptare
- Reforma e burgjeve dhe shoqëria civile në Shqipëri – Monitorimi dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut në Vendet e Paraburgimit dhe Burgjet në Shqipëri, dhe Rritja e Shkallës së Ndërgjegjësimit dhe e Njohurive për të Drejtat e Njeriut në Shtetin e së Drejtës në këtë Fushë
- Drejtimi i paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut
- Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore për promovimin dhe respektimin më të mirë të të drejtave të minoriteteve
- Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer
- Standartet europiane dhe respektimi i të drejtave të emigrantëve

3. Publikime të KSHH-së

4. Zhvillimi institucional i KSHH-së

5. E ardhmja e KSHH-së

- For better protection of victims' rights in Albania
- Better respect for the rights of women and juveniles at penitentiary institutions
- Respect for the highest interest of children – an obligation for all
- Human prisons management
- Prison Reforms and Civil Society in Albania - Monitoring the Respect of Human Rights in Prisons and Pre-Detention Sites in Albania, and Enhancing Awareness and Recognition of Human Rights and Rule of Law in this Area
- A human rights approach to pre-detention management
- Enhancing the role of the civil society and state institutions for the promotions and better respect for minority rights
- Respect for the rights of albanian emigrants and returned persons
- European standards and respect for emigrants' rights

3. AHC publications

4. AHC's institutional development

5. AHC's future

Fjala përshëndetëse

I/E dashur lexues/e

Viti 2007 ishte një vit me zhvillime dinamike në fushën e reformave ligjore e institucionale dhe të forcimit të shtetit të së drejtës. Përpjekjet e Shqipërisë për të përmbushur standartet për anëtarësimin në familjen europiane ishin të shumta. KShH si pjesë e shoqërisë civile ishte aktive dhe veproi në disa prej fushave që janë prioritare për integrimin e Shqipërisë në familjen europiane.

Duke qenë të ndërgjegjshëm se respektimi i të drejtave të njeriut dhe forcimi i shtetit të së drejtës arrihen me përpjekje të përbashkëta të të gjithë aktorëve shtetërore dhe joshtetërore, organizime dhe individë, KShH, stafi, korrespondentët dhe vullnetarët e tij i kushtuan vëmendje monitorimit të të drejtave të njeriut në fusha me përparësi dhe që janë pjesë e misionit të KShH-së, përmirësimit të ligjeve dhe praktikave të zbatimit të tij, veprimtarive mbrojtëse, lobuese dhe sensibilizuese të të drejtave të njeriut, rritjes së kapaciteteve të administratës së disa prej institucioneve me rëndësi në respektimin e të drejtave të njeriut.

Introductory speech

Dear reader

2007 was a year with dynamic developments in the area of legal and institutional reforms and that of the rule of law. Albania's efforts to meet the standards for membership in the European family were numerous. AHC, as part of the civil society, was active and operated in some of the areas that are priorities for Albania's integration into the European family.

Being aware that respect for human rights and strengthening the rule of law are achieved through concerted efforts of all actors, state and non-state, organizations and individuals, AHC, its staff, correspondents, and volunteers devoted attention to monitoring human rights in priority areas that are part of AHC's mission, to the improvement of laws and the practice of their implementation, protection, lobbying, and sensitizing activities on human rights, building the capacities of some institutions that are important in ensuring respect for human rights.

Grupet me në nevojë si fëmijët dhe gratë, minoritetet në përgjithësi, ai Rom dhe komuniteti egjiptian në veçanti, personat e privuar nga liria, emigrantët e rregullt dhe të parregullt, qytetarët në zonat rurale dhe jashtë kryeqytetit ishin në vëmendje të KShH-së.

Gjatë vitit 2007, KShH-ja rriti bashkëpunimin me organizatat vendase dhe të huaja, me përfaqësues të medias dhe të institucioneve, duke qënë bashkëpunuese dhe oponencë konstruktive.

Viti 2007, krahasuar me një vit më parë ishte një vit më me shumë veprimtari dhe shtrirje, dinamizën dhe larmishmëri; me më shumë përgjegjësi dhe sfida. Me të njëjtin staf dhe korrespondentë, KShH-ja ishte më e pranishme, me reaguese dhe ndërkohë me shumë e përfshirë në ofrimin e oponencave, mendimeve; rriti bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare.

Një nga sfidat me të cilat u përballë KShH dhe stafi i tij ishte nevoja e shoqërisë shqiptare për të patur një organizatë të pranishme dhe mundësitë e organizatës për t'iu përgjigjur nevojave. Numri i shtetasve që iu drejtuan KShH-së u rrit dhe bashkë me të edhe nevoja për rritje të profesionalizimit, të dinamizmit dhe të reagimit në mbrojtje të të drejtave të shtetasve. Nga ana tjetër, mbështetja e organizatës nga donatorë të huaj dhe me projekte afatshkurtër dhe të orientuara në fusha dhe drejtime të përcaktuara që në fillim, e vuri organizatën në situatë që i duhej të shpenzonte kohë dhe energji për gjetje të burimeve të reja të mbështetjes dhe të hartimit të strategjive të reja.

Groups in most need, such as children and women, minorities in general, the Roma minority and the Egyptian community in particular, persons deprived of their liberty, regular and irregular emigrants, citizens in the rural areas and in areas out of the capital, were part of AHC's attention.

During 2007, AHC enhanced cooperation with local and foreign organizations, representatives of the media and institutions, being a collaborator and a constructive opponent.

Compared to the previous year, 2007 was a year with more activities, more outreach, dynamism, and diversity; it likewise had more responsibilities and challenges. Although it had the same staff and correspondents, AHC was more present, more reactive, and meanwhile more involved in critiques and opinions; it enhanced cooperation with state institutions and international organizations.

One of the challenges that AHC and its staff encountered was the need of the Albanian society to have an organization that was present and the capacities of the organization to respond to the needs. The number of citizens that addressed the AHC increased and with it, the need for greater professionalism, dynamism, and reaction for the defense of citizens' rights. On the other hand, the support by foreign donors with short-term projects oriented toward pre-determined areas placed the organization in a position whereby it had to spend time and energies to find new sources of support and drafting new strategies.

Viti 2007 ishte viti kur organizata kushtoi kohë, mendim, energji për forcimin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare të saj. Të gjitha përpjekjet u finalizuan me hartimin e strategjisë për periudhën 2008-2010.

Ky raport paraqet fushat dhe veprimtaritë kryesore ku KShH-ja veproi. E gjithë veprimtaria e komitetit nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e anëtarëve të Asamblesë dhe të bordit të KShH-së, pa përpjekjet e përbashkëta të stafit dhe të korrespondentëve të KShH-së, të paktë në numër, por energjik, profesional, të palodhur dhe të përkushtuar, aktivistëve të tij, ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që pranuan dhe bashkëpunuan me stafin e KShH-së dhe kontribuan në përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të KShH-së.

Veprimtaria e KShH-së u bë e mundur falë mbështetjes dhe bashkëpunimit me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore. Pavarësisht momenteve ose rasteve kur kritika dhe qëndrimet e KShH-së edhe mund të mos jenë kuptuar drejt ose mirëpritur, KShH-ja vlerëson se bashkëpunimi me institucionet është jo vetëm i nevojshëm, por edhe i dobishëm.

Veprimtaria e KShH-së nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen morale, profesionale dhe financiare të partnerëve tanë, donatorë. Një pjesë e madhe e tyre fizikisht janë larg Shqipërisë, por kanë qenë dashamirës, mbështetës, inspirues dhe bashkëpunues me stafin e KShH-së në përpjekjet e tij për të kontribuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë në vend; kanë mirëkuptuar dhe vlerësuar punën e palodhur, të vështirë, profesionale, që merr

2007 was the year when the organization spent time, thinking, and energies for its own institutional strengthening and financial sustainability. All efforts were finalized with the compilation of the strategy for the period 2008-2010.

This report presents the areas and main activities in which AHC was active. All of the Committee's activity would not have been possible without the support of the members of AHC's Assembly and Board, without the joint efforts of the staff and AHC's correspondents who were scarce in number, yet energetic, professional, untiring, and committed, its activists, national and international experts who agreed to and cooperated with the staff and contributed to fulfilling the mission and strategic objectives of the AHC.

AHC's activity was made possible thanks to the support of and cooperation with national and local state institutions. In spite of moments or cases when AHC's critiques and stances may not have been rightly understood or welcomed, AHC considers that cooperation with institutions is not only necessary, but also useful.

AHC's activity would not have been possible without the moral, professional, and financial support of our partners, the donors. A good part of them are physically far from Albania, but they still were benevolent, supportive, and cooperative with AHC's staff in its efforts to contribute to respect for human rights and the strengthening of democracy in the country; they understood and appreciated the untiring, difficult, professional, and energy-consuming work that takes up a lot from the personal and

shumë energji dhe kohë nga jeta personale dhe familjare e të gjithëve dhe që nuk njih orare dhe plane të përcaktuara.

Me lejon, që të shpreh falenderime, mirënjohje dhe respekt kolegëve të mi të KShH-së, anëtarëve të Asamblesë dhe bordit, korrespondentëve e aktivistëve të KShH-së, bashkëpunëtorëve vendas e të huaj dhe donatorëve, përfaqësuesve të medias për kontributin e tyre për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

family life of all and knows no work schedule or pre-defined plans.

Allow me to express my thanks, gratitude, and respect for my colleagues of the AHC, the members of the Assembly and the Board, AHC's correspondents and activists, domestic and foreign collaborators, and the donors and media representatives for their contribution to improving respect for human rights in Albania.

Faleminderit Thank you.

Prof.as. dr. Vasilika Hysi ***Prof.as. dr. Vasilika Hysi***

Drejtoresh e ekzekutive ***Executive Director***

Veprimtaria e KShH-së sipas fushave
Activity of AHC according the fields

Komiteti Shqiptar i Helsinki në vitin 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit – organizatë e veprimtarëve të të drejtave të njeriut

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja), organizata e parë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, u themelua si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut në 19 dhjetor 1990. KShH-ja është një shoqatë me anëtarësi. Anëtarët e tij janë personalitete të njohur, që shquhen për ekspertizën e përvojën e tyre në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. KShH-ja ka një bord këshillues, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e tij.

Gjatë vitit 2007, stafi profesional i KShH bashkëpunoi me rrjetin e korrespondentëve në qytete të ndryshme, të cilët ofruan energji dhe ekspertizë. Ky rrjet u mobilizua jo vetëm për të ushqyer zyrën e KShH-së në Tiranë, për ta orientuar atë mbi “problemet e nxehta dhe urgjente” që ekzistojnë në nivel vendor, por edhe për të monitoruar aksesin e minoriteteve në organet e qeverisjes vendore, respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të rivendosur të drejtat e

The Albanian Helsinki Committee in 2007

Albanian Helsinki Committee – an organization of human rights activists

The Albanian Helsinki Committee (AHC), the first organization for the protection of human rights and freedoms in Albania, was founded as the Forum for the Protection of Fundamental Human Rights and Freedoms, on December 19, 1990. AHC is a membership association. Its members are known personalities who stand out for their expertise and experience in the area of the promotion and protection of human rights. AHC has an advisory board, elected by its General Assembly.

During 2007, AHC's professional staff cooperated with the network of its correspondents in different cities who offered energy and expertise. The network was mobilized not only for providing input to AHC's office in Tirana and orient it toward “hot and urgent issues” existing at the local level, but also to monitor minorities' access to local government bodies, respect for human rights, and reinstate violated rights. AHC also acted through a broad

shkelura në vend. KShH-ja veproi edhe përmes një rrethi të gjërë vullnetarësh, ekspertësh kombëtarë e ndërkombëtarë.

Cili është vizioni dhe misioni i KSHH-së në shoqërinë civile shqiptare?

KShH beson në një shoqëri shqiptare ku qytetarët ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë themelore të tyre në të gjitha aspektet e jetës. Misioni i KShH-së është të kontribuojë për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës në përputhje me të drejtat e njeriut sipas Aktit Final të Helsinkit dhe dokumenteve të tij pasuese, me detyrimet ligjore ndërkombëtare të ndërmarra nga Këshilli i Europës dhe Kombet e Bashkuara, si dhe me normat e të drejtave të njeriut promovuar nga Bashkimi European.

Mandati i KShH-së është të monitorojë, llobojë, mbështesë, së bashku me aktorë të tjerë të shoqërisë civile dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, përmbushjen e standardeve për të drejtat dhe liritë themelore; të sensibilizojë qytetarët shqiptarë dhe të gjithë aktorët përkatës mbi këto të drejta; të rrisë llogaridhënien e administratës publike për zbatimin e duhur të ligjeve nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të saj si dhe të ofrojë oponencë ligjore për përmirësimin e legjislacionit dhe zbatimit të tij në praktikë. KShH-ja bën shumë përpjekje për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të brendshme të tjera.

network of volunteers, national and international experts.

What is the vision and mission of AHC in the Albanian civil society?

AHC believes in an Albanian society in which the citizens exercise their fundamental rights and freedoms freely in all aspects of life. AHC's mission is to contribute to better respect for human rights and the strengthening of the rule of law in accordance with human rights, in keeping with the Final Helsinki Act and its subsequent documents, with international legal obligations undertaken by the Council of Europe and the United Nations, as well as with human rights norms promoted by the European Union.

AHC's mandate is to monitor, lobby for, and support, together with other civil society actors and national and international organizations, the fulfillment of standards for fundamental rights and freedoms; sensitize Albanian citizens and all the respective actors about these rights; increase the accountability of the public administration for the proper implementation of laws, through strengthening its capacities; and, offer legal critique for the improvement of legislation and its implementation in practice. AHC makes sustained efforts for further strengthening its own internal capacities.

Vlerat e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

KShH është një organizatë, e cila demonstroi besim në vlera të tilla si: paanshmëria, objektiviteti, integriteti në çështje të drejtave të njeriut, standarde, përkushtim, profesionalizëm gjithnjë në rritje, ambicie, energji dhe pasion, asistencë konkrete, si dhe transparencë në qëndrimin e saj ndaj demokratizimit të drejtave të njeriut dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Viti 2007 ishte viti i kurorëzimit të planit strategjik 2008-2010

Gjatë vitit 2007 stafi i KShH-së punoi dhe finalizoi planin strategjik 2008-2010. KShH përcaktoi fushat e veprimtarisë dhe strategjitë e ndërhyrjes së tij gjatë tre viteve në vazhdim. Dokumenti është frut i punës së stafit të KShH-së, të tryezave, analizave dhe diskutimeve të shumta të tyre, mbledhjeve të Asamblesë dhe Bordit të KShH-së, konsultimeve me bashkëpunëtorë, përfitues të drejtëpërdrejtë dhe partnerë të tij. Në këtë proces dhanë kontribut të çmuar ekspertë të pavaruar, kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Plani strategjik pasqyron mendimet dhe sugjerimet e çmuara të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, medias, analistë të pavaruar, diplomatë në Shqipëri, donatorë, partnerë dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Values of the Albanian Helsinki Committee

AHC is an organization that demonstrates belief in values such as: impartiality, objectivity, integrity in issues of human rights, standards, dedication, ever-increasing professionalism, ambition, energy, and passion, concrete assistance, as well as transparency in its stance toward the democratization of human rights and the strengthening of the rule of law.

2007 saw the finalization of the 2008-2010 strategic plan

During 2007, AHC's staff worked and finalized the 2008-2010 strategic plan. AHC determined the areas of its activity and strategies for its interventions during the subsequent three years. The document was the product of the work of AHC's staff, round table discussions, analyses, and numerous discussions thereof, meetings of AHC's Assembly and Board, consultations with collaborators, direct beneficiaries and partners of the Committee. Independent, domestic and international, experts gave valuable contribution to this process. The strategic plan reflects the precious views and suggestions of representatives of state institutions, the civil society, media, independent analysts, diplomats in Albania, donors, international partners and organizations in Albania.

KSHH-ja synoi të ishte një organizatë e qëndrueshme, transparente dhe e orientuar drej rezultateve

Duke qenë të ndërgjegjshëm për t'u shërbyer më mirë interesave të qytetarëve dhe për të ofruar mbrojtjen e të drejtave të tyre, një organizatë duhet të kujdeset vazhdimisht për nevojat e saj të brendshme. Edhe gjatë vitit 2007, KShH-ja vazhdoi t'i kushtojë kujdes forcimit të kapaciteteve financiare dhe institucionale të tij, të ishte e pranishme dhe aktive në nivel qendror dhe vendor.

AHC sought to be a sustainable, transparent, and results-oriented organization

Being aware of the need to better serve the interests of citizens and to offer protection for their rights, an organization should constantly care about its internal needs. During 2007, AHC continued to devote care to strengthening its financial and institutional capacities and to being present and active at the central and local level.



Vëzhgime të respektimit të të drejtave të njeriut

Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të njeriut ishte një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së KSHH-së gjatë vitit 2007. Disa nga fushat e vëzhgimit ishin: zgjedhjet vendore, të drejtat e personave të ndaluar, të paraburgosur të arrestuar dhe të dënuar, të drejtat e emigrantëve, pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike, të drejtat e njeriut dhe minoritetet në kuadër të MSA-së.

150 vëzhgues afatgjatë të KSHH-së të akredituar nga KQZ-ja vëzhguan fushatën zgjedhore dhe procesin e votimit të 18 shkurtit 2007 në rrethet më të mëdha të vendit dhe në disa komuna ku janë të përqëndruara minoritetet dhe

Monitoring respect for human rights

Monitoring respect for human rights was one of the main pillars of AHC's activity during 2007. Some of the areas monitored were: the local elections, the rights of detained, in pre-trial detention, arrested, and convicted, emigrants' rights, the participation of minorities in public life, human rights and minorities in the context of the SA Agreement.

150 of AHC's long-term observers, accredited by the CEC, monitored the electoral campaign and the voting process of February 18, 2007, in the country's largest cities and in some communes with concentrations of



popullsia e ardhur nga rrethe të tjera. Gjithashtu, 15 vëzhgues të akredituar të KShH-së vëzhguan zgjedhjet e pjesshme parlamentare dhe procesin e numërimit të votave në KZZ-në përkatëse në zonën nr.31 Tiranë, përfshirë edhe procesin zgjedhor në institucionet e veçanta si: institucioni i vuajtjes së dënimit “Mine Peza” dhe institucioni i paraburgimit “Jordan Misja”, dhe Materniteti “Mbretëresha Geraldinë”. Në përfundim të vëzhgimeve u hartuan dhe u bënë publike raportet e vëzhgimeve. Për më shumë mund të lexoni <http://ahc.org.al/kshh/zgjedhjet/raporteZGJEDHJET.html>

KShH-ja në bashkëpunim me organizata partnere monitoroi progresin e bërë në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe përmbushjes së detyrimeve për në BE dhe ofroi oponencë konstruktive në fushat objekt monitorimi me qëllim përshpejtimin e reformave për integrimin evropian të vendit tonë.

Duke vlerësuar nevojën e respektimit më të mirë të të drejtave të personave që kalojnë në pikat e kalim-kufirit, gjatë vitit 2007, KShH-ja kreu 26 misione vëzhgimi në pikat kryesore të kalimit kufitar me Greqinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën. Disa pika kalimi u vëzhguan më shumë se një herë me qëllim që të ndiqej nga afër zbatimi i rekomandimeve të KShH-së të lëna nga vëzhgimet e mëparshme. Takime me drejtues të lartë dhe punonjës të policisë kufitare, intervista me emigrantë shqiptarë të rregullt dhe që kishin kaluar kufirin në mënyrë të parregullt, vëzhgimi i pikave të kalimit të kufirit ishte metodologjia e përdorur. Bazuar në gjetjet e vëzhgimeve, KShH adresoi problemet e konstatuara, rekomandimet dhe sugjerimet tek organet

minorities and inhabitants coming from other areas. Also, 15 accredited observers of AHC monitored the partial parliamentary elections and the vote count in the respective ZEC in constituency 31 in Tirana, including the voting process in special institutions, such as: the “Mine Peza” institution for serving prison terms and the pre-trial detention institution “Jordan Misja,” as well as the “Queen Geraldine” Maternity Hospital. At the conclusion of the elections, monitoring reports were prepared and made public. For more information, you may read at <http://ahc.org.al/kshh/zgjedhjet/raporteZGJEDHJET.html>.

In cooperation with other partner organizations, AHC monitored progress made in the area of respect for human rights and the fulfillment of obligations for the EU, as well as offered constructive critique in the areas that were the target of monitoring, with a view to accelerating reforms for the country’s European integration.

Appreciating the need for better respect for the rights of persons who go through border-crossing points, during 2007, AHC conducted 26 observation missions at the main border crossing points with Greece, Montenegro, Macedonia, and Kosovo. Some border crossing points were monitored more than once, in order to follow up on recommendations submitted by AHC during previous observations. The methodology used for this purpose included meetings with senior officials and officers of border police, interviews with Albanian regular emigrants who had crossed the border irregularly, and the observation of border crossing points. Based on the observation findings, AHC raised the encountered problems, recommendations, and suggestions with

përgjegjëse shtetërore. Për më shumë rreth kësaj çështje mund të lexoni. <http://ahc.org.al/kshh/emigrantet/emigrantet2html/> .

Gjatë vitit 2007, KShH-ja vëzhgoi respektimin e të drejtave të të paraburgosurve pas kalimit të vendeve të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, institucionet e paraburgimit dhe burgjet në rrethet Berat, Vlorë, Krujë, Kukës, Tropojë, Korçë, Rrogozhinë, Peqin, Lezhë dhe Qendra Spitalore e Burgjeve, Tiranë me fokus kryesor të drejtat e personave të paraburgosur në përgjithësi, dhe ato të të miturve dhe grave në veçanti.

Bazuar në gjetjet e vëzhgimeve, KShH vuri në dijeni institucionet kryesore përgjegjëse për situatën e të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime si dhe dha sugjerime dhe rekomandime konkrete për përmirësimin saj. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të rënda, KShH-ja ka reaguar publikisht me anë të një deklaratave për shtyp.

Pjesëmarrja e minoriteteve në vendimarrjen vendore vazhdoi të ishte në vemendje të KShH-së. KShH realizoi anketimin e publikut dhe një vetvlerësim të administratës së bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë në bashkitë: Tiranë, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë. Bazuar në një metodologji të caktuar u bë mundur të mblidhen të dhëna rreth pjesëmarrjes së minoriteteve në vendimarrje, respektimit të të drejtave të minoriteteve në nivel vendor, problemeve që shqetësojnë minoritetet. Studimi është një bazë mbi të cilën mund të hartohen dhe zhvillohen strategji dhe ndërhyje nga këshillat bashkiake, aktorët vendor, vetë shoqëria civile, media në nivel vendor dhe qëndror. Për më shumë rreth gjetjeve të studimit mund

the relevant state authorities. For more information on this issue, you may visit <http://ahc.org.al/kshh/emigrantet/emigrantet2html/>.

During 2007, AHC observed respect for the rights of pre-trial detainees, after detention facilities were placed under the responsibility of the Ministry of Justice, the pre-trial detention facilities and prisons in the districts of Berat, Vlorë, Krujë, Kukës, Tropojë, Korçë, Rrogozhinë, Peqin, Lezhë and the Prison Hospital Center, in Tirana, with the main focus being the rights of detainees in general and the rights of juveniles and women in particular.

Based on the findings of observations, AHC alerted the responsible state authorities regarding the human rights situation in prisons and detention facilities and also presented concrete suggestions and recommendations for its improvement. When faced with serious violations, AHC reacted publicly through press statements.

The participation of minorities in local decision making remained in the attention of AHC. The Committee realized a public opinion survey and a self-assessment of the administration of municipalities and municipal council members in the municipalities of Tiranë, Elbasan, Fier and Gjirokastrë. Based on a given methodology, it was possible to collect data regarding the participation of minorities in decision making, respect for minorities' rights at the local level, and problems of concern for minorities. The research is a basis on which to build and develop strategies and interventions by municipal councils, local actors, the civil society, and the media at the local and the national level. For more information on the research find-

të lexoni <http://ahc.org.al/kshh/.minoriteti/MINORITETI/html>.

Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi vazhdoi të ishte në vëmendje të KShH-së dhe organizatave homologe në Greqi. Gjatë vitit 2007, KShH-ja bashkëpunoi ngushtë me Monitoruesin Grek të Helsinkit me qëllim të ofrimit të një mbrojtje më efektive të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe prezantimin e rasteve të tyre në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, përfaqësues të KShH-së organizuan një vizitë në Athinë. Në takimet me shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, përfaqësues të shërbimeve konsullore në Athinë, me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit Grek, të medias shqiptarë dhe greke në Greqi diskutuan për integrimin e emigrantëve shqiptarë në Greqi dhe vështirësitë që hasin një pjesë e konsiderueshme e tyre.

ings, please visit <http://ahc.org.al/kshh/.minoriteti/MINORITETI/html>.

Respect for the rights of Albanian emigrants in Greece remained at the focus of AHC and peer organizations in Greece. During 2007, AHC cooperated closely with the Greek Helsinki Monitor in order to offer a more effective protection of the rights of Albanian emigrants and be able to present their cases to the European Court of Human Rights. Furthermore, AHC representatives organized a visit to Athens. During meetings with Albanian emigrants' associations in Greece, representatives of consular services in Athens, representatives of the Greek People's Advocate, Albanian and Greek media in Greece, AHC representatives discussed about the integration of Albanian emigrants in Greece and difficulties that a considerable part encounters.

Reforma ligjore ka rëndësi, por jo pak rëndësi ka cilësia e saj

Të bindur se respektimi i të drejtave të njeriut varet nga ligjet dhe cilësia e tyre në një shoqëri, gjatë vitit 2007 KShH-ja ka ndjekur me vëmendje reformën ligjore në disa nga fushat që janë objekt i veprimtarisë së saj dhe ka ofruar mendime e vlerësime kritike për përmirësimin e tyre.

Strategjitë e përdorura ishin: ofrimi i mendimeve për projektligje të reja, strategji ose ndryshimet në ligjet ekzistuese; pjesëmarrja në takime dhe tryeza për diskutimin e nismave ligjore ose zbatimin e rekomandimeve të mekanizmave monitorues kombëtarë dhe ndërkombëtarë; pjesëmarrja në seanca dëgjimore në komisionet parlamentare; diskutimi i problemeve ligjore, të kuptimit dhe zbatimit të tyre me përfaqësues të organeve shtetërore dhe reagimi publik në rastet e çënimeve të rënda të drejtave të njeriut në procesin e draftimit dhe të diskutimit të ligjeve.

KShH-ja bashkëpunoi me Komisionin parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtave të Njeriut, me Zyrën e Përfaqësuesit Ligjor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RSH-së, me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, etj.

Legal reform is important, its quality not less

Convinced that respect for human rights depends on the laws and their quality in a society, during 2007, AHC followed with attention legal reform in areas that are the target of its activity and offered its critiquing views and evaluations for there improvement.

The strategies employed were: offering views on new draft laws, strategies or changes in existing laws; participation in meetings and round table discussions to discuss legal initiatives or the implementation of recommendations by national and international monitoring mechanisms; participation in hearing sessions of parliamentary commissions; discussion of legal issues, their understanding and implementation with representatives of state bodies, and public reactions incases of serious violations of human rights in the process of drafting and discussing laws.

AHC cooperated with the Parliamentary Commission on Legal Issues, the Public Administration, and Human Rights, the Office of the Legal Representative at the Ministry of Foreign Affairs, the Ministry of Justice, the General Directorate of Prisons, etc.

Gjatë vitit 2007, KShH-ja ofroi mendime ligjore për 21 projektligje, projektstrategji ose nisma për ndryshime të ligjeve. Më konkretisht:

- Projekt ligji “Për Shërbimin Ligjor Falas” (16 mars 2007)
- Projektligji “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë (maj 2007)
- Projektligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”(maj 2007).
- Lidhur me zbatimin e pesë rekomandimeve të Këshillit të Europës në fushën e të drejtave të njeriut (16 shkurt 2007 në takimin e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë),
- Sugjerime për hartimin e një politike për kujdesin shëndetësor në sistemin penitenciar shqiptar, nevoja e hartimit të një politike për kujdesin shëndetësor në sistemin penitenciar, me fokus të veçantë sëmundjet ngjitëse, nisur nga problematika që shfaqet në këtë drejtim.
- Ekspertizë lidhur me kriteret e përzgjedhjes së personelit të burgjeve të reja, hartimin e procedurave të përzgjedhjes së personelit në sistemet e tjera penitenciare.
- Oponenca ligjore lidhur me projekt ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”
- Oponencë ligjore lidhur me ndryshimet në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar”
- Oponencë ligjore lidhur me ndryshimet në Kodin penal dhe të procedurës penale
- Oponencë për projektligjin “Për kompesimin e të dënuarve politikë”, shtator 2007

During 2007, AHC offered legal opinions on 21 draft laws, draft strategies, or initiatives of amendments of laws. In concrete terms:

- Draft law "On free legal service" (March 16, 2007)
- Draft law "On penal responsibilities of juridical entities" (May 2007)
- Draft law "On the organization of the judicial branch in the Republic of Albania" (May 2007)
- On the implementation of five recommendations of the Council of Europe in the area of human rights (February 16, 2007, meeting organized by the Ministry of Foreign Affairs of Albania)
- Suggestions for drafting a policy on health care in the Albanian penitentiary system, the need to draft a policy on health care in the penitentiary system, with special focus on infective diseases, stemming from the problems appearing in this direction
- Expertise regarding criteria for the selection of new personnel of new prisons, drafting of selection procedures of personnel in other penitentiary systems
- Legal critique on the draft law "On the execution of penal decisions"
- Legal critique regarding amendments to the law "On the rights and treatment of convicted persons"
- Legal critique regarding amendments to the Penal Code and the Penal Procedure Code
- Legal critique on the draft law "On the compensation of politically convicted persons," September 2007

- Legal critique on the draft law "On the prevention of HIV/AIDS" (November 2007)
- Legal critique on the draft law "On the control and supervision of the state border"
- Legal critique on the draft law "On foreigners" (November-December 2007)
- Legal critique on the draft law "On the protection of personal data" (December 2007)
- Legal critique on the draft law on the draft law on tourism, seen from the standpoint of respect for privacy (May 14, 2007)
- Legal critique on the draft law on the decision of the Council of Ministers "On the employment of persons deprived of their liberty"
- Opinions on sectoral and inter-sectoral strategies in the area of justice, police, prisons, minorities, strategies against terrorism, trafficking of human beings, etc.

Përmirësimi i praktikave të zbatimit të ligjeve

Bazuar në vlerësimin e KShH-së dhe të mekanizmave të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë monitorues, zbatimi i ligjeve vazhdon të përbëjë shqetësim në vendin tonë. Duke qënë të bindur në faktin se ligjet e mira përbëjnë bazën e respektimit të të drejtave të njeriut, por ata duhet të kuptohen dhe të zbatohen në mënyrë të njëjtë dhe për të gjithë, KShH-ja i kushtoi shumë kohë dhe energji përmirësimit të praktikave të zbatimit të ligjeve.

KShH-ja mori pjesë dhe ofroi mendime në mbledhjet e grupeve të punës të ngritura nga Zyra e Përfaqësuesit Ligjor në Ministrinë e Punëve të Jashtme për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), për reformimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe zbatimin e vendimeve të saj dhe lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT).

Bazuar në përvojën e pasur të tij, KShH ka shprehur mendimin e tij për reformën ligjore në drejtim të mosdiskriminimit, trajtimin e azilkërkuesve, të drejtat e

Improvement of the practice of law enforcement

Based on the assessment of AHC and other national and international monitoring mechanisms, law enforcement remains a concern for the country. Convinced about the fact that good laws are the basis for respect for human rights, when understood and implemented equally for all, AHC devoted a lot of time and energy to improving the practice of the enforcement of laws.

AHC participated in and offered its views in meetings of working groups established by the Office of the Legal Representative at the Ministry of Foreign Affairs, for the implementation of recommendations by the European Commission against Racism and Intolerance (ECRI), for the reformation of the European Court of Human Rights and the implementation of its decisions, and for the implementation of recommendations by the Committee for the Prevention of Torture (CPT).

Based on its rich experience, AHC expressed its views regarding legal reform in terms of non-discrimination, the treatment of asylum-seekers, the rights of minorities

minoriteteve në përgjithësi, dhe atij rom dhe komunitetit egjiptian në veçanti, reformat ligjore dhe praktikat e zbatimit të ligjit; ka shprehur shqetësimet dhe rekomandimet e veta lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe ka vepruar për njohjen më të mirë të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, KShH ofroi mendimet dhe sugjerimet e tij në disa fusha të Strategjisë dhe të strategjive sektoriale si: policia, sistemi i paraburgimit dhe burgje, drejtësia, minoritete. Mendimet e tij, KShH i ka shfaqur në tryezat e rrumbullakëta të mbajtura për këtë qëllim si dhe ua ka dërguar me shkrim autoriteteve kompetente. Ai ofroi ekspertizë për Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve lidhur aspekte të veçanta të menenaxhimit në mënyrë humane të burgjeve.

Në mbrojtje të lirisë së shtypit, KShH-ja i sygjeroi Kuvendit të Shqipërisë rishikimin e nenit 159 të Kodit të Proçedurës Penale, sipas të cilit paragrafi 3 këtij neni bie ndesh me frymën e Kushtetutës së Shqipërisë, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sa i takon parimit të mbrojtjes së lirisë së shtypit.

Duke vlerësuar rolin e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut dhe të grupeve të interesit në procesin e hartimit të ligjeve, KShH-ja ka sugjeruar që projektligjet para miratimit nga komisionet përkatëse ose nga seanca plenare e Kuvendit të Shqipërisë të bëhen objekt diskutimi dhe debati në një rreth më të gjerë të specialistëve të fushës kushtetuese, të ligjit dhe të praktikës, ekspertë të pavaruar nga shoqëria civile dhe media.

in general and the Roma one and the Egyptian community in particular, legal reforms and the practice of law enforcement; its views and recommendations regarding respect for the rights of persons deprived of their liberty and worked for better recognition of decisions of the European Court of Human Rights.

In the context of drafting the National Strategy for Development and Integration 2007-2013, AHC offered its views and suggestions in some areas of the Strategy and some sectorial strategies, such as: the police, the detention and prison system, justice, and minorities. AHC expressed its views at round table discussions held for this purpose and submitted them in writing to the competent authorities. It offered expertise to the Ministry of Justice and the General Directorate of Prisons regarding specific aspects of prison management.

To protect freedom of the press, AHC suggested to the Assembly of Albania a revision of article 159 of the Penal Procedure Code, whose paragraph 3 is in contravention of the spirit of the Constitution of Albania, the European Convention of Human Rights, and the practice of the European Court of Human Rights, with regard to the principle of protecting press freedom.

Appreciating the role of transparency and participation of the public and interest groups in the process of drafting of laws, AHC suggested that before approval by the respective commissions or the plenary session of the Assembly of Albania, draft laws become the target of discussions and debates in a broad circle of specialists of the constitutional field, of law and its practice, and independent experts from the civil society and the media.

Bashkëpunime Veprimtari të përbashkëta

Cooperation Joint activities

Gjatë vitit 2007 në vëmendje të KShH-së ka qënë bashkëpunimi me institucionet shtetërore, organizatat vendase dhe të huaja, kryesisht për trajtimin e ankesave të ardhura, për gjëndjen e të drejtave të njeriut, për çështje të ndryshme ligjore dhe praktike, dhënie mendimesh në kuadër të draftimit të ligjeve etj. KShH-ja ka bashkëpunuar me insitucione që veprojnë në fushat e veprimtarisë së KShH-së dhe në të cilat ai ka qënë aktiv gjatë vitit 2007. Bashkëpunimet dhe/ose komunikimet më të shpeshta janë realizuar kryesisht me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, drejtoritë e institucioneve të riedukimit, prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, organet e qeverisjes vendore, me organizatat vendase dhe të huaja të të drejtave të njeriut, etj.

Kjo veprimtari tregon rolin konstruktiv të KShH-së si një organizatë oponencë dhe kritike, por edhe bashkëpunuese për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut.

During 2007, AHC's attention included cooperation with state institutions, local and foreign organizations, mainly to address received complaints, on the situation of human rights, on different legal and practice issues, on providing opinions in the context of drafting of laws, etc. AHC cooperated with institutions working in the AHC's areas of activity in which it was active during 2007. More frequent cooperation and/or communications took place with the Central Election Commission, the General Directorate of Prisons, local prisons, prosecutor's offices of judicial districts, the Ministry of Justice, the Ministry of Foreign Affairs, local government bodies, domestic and foreign human rights organizations, etc.

This activity is testimony to AHC's constructive role as an organization of critique, but also of cooperation for the improvement of respect for human rights.

KShH forcoi bashkëpunimin dhe koordinimit me organizatat vendase dhe të huaja që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Disa prej bashkëpunimeve dhe veprimtarive të realizuara gjatë vitit 2007 janë:

Takim me z. Alfred Moisiu, President i RSH

Në prag të zgjedhjeve vendore të 18 shkurtit 2007, përfaqësuesja e KShH-së u ftua nga Z. Alfred Moisiu, President i Republikës së Shqipërisë në një takim me aktorë të shoqërisë civile. Z. Alfred Moisiu vlerësoi rolin e shoqërisë civile në zhvillimin e demokracisë në përgjithësi dhe vëzhgimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë. Ndër të tjera, në takim u diskutua për fushatën zgjedhore, respektimin e Kodit të Sjelljes, transparencën në financimin e fushatës elektorale dhe respektimin e të drejtës së votës.

Nënshkrimi i promemories lidhur me procesin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë

Duke vlerësuar rëndësinë e procesit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë si kryetar shteti dhe përfaqësues i unitetit të popullit, më 11 maj 2007, përfaqësues të disa grupeve të shoqërisë civile mes të cilave edhe KShH, përfaqësues të akademikëve dhe Konferenca e Rektorëve të Universiteteve të Shqipërisë nënshkruan një promemorie drejtuar autoriteteve më të larta në të cilin kërkohej që partitë politike të zbatojnë rregullat kushtetuese të zgjedhjes së Presidentit dhe të gjejnë konsensusin në zgjedhjen e Presidentit të RSH-së

AHC strengthened cooperation and coordination with local and foreign organizations working in the area of human rights. Some of these cooperation and activities conducted during 2007 include:

Meeting with Mr. Alfred Moisiu, President of the Republic

